

Korrik – Dhjetor 2025

AMSHC ➤ Ditar 33

Datë: 08.01.2026

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

Mbledhja e Komitetit Drejtues të Programit “Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri (SCPA)	1
Takime informuese me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile për vendet vakante si anëtarë të Shoqërisë Civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile	4
Njoftim për FITUESIT e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të Shoqërisë Civile në KKShC	6
Takimi i Ekipit Tematik për Monitorimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Viktimave të Krimit	7
Konferenca e parë Rajonale në lidhje me programin ReLOaD 3ër Shoqërinë Civile.....	8
Takimi në kuadër të programit “Akademia e OJF-ve 2025”	10
Takim konsultativ për forcimin e rolit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.....	11

Mbledhja e Komitetit Drejtues të Programit “Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri (SCPA)”

Tiranë, 30 korrik 2025



Më 30 korrik 2025, Programi SCPA organizoi takimin e dytë të Këshillit Drejtues (KD) me pjesëmarrjen e palëve të ndryshme të interesuara. Mbledhja e KD u bashkëkryesua nga Z. Rebani Jaupi, Drejtor i Departamentit për Rendin dhe Sigurisë Publike në PSH dhe Znj. Linda Gjermani, Menaxhere e Programit në Ambasadën e Suedisë. Në takim morën pjesë palë të interesuara si drejtuesit e PSH në fushën e sigurisë publike dhe trajnimit të policisë, përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile dhe Shoqata për Autonomi Vendore.

Drejtori i PSH, Z. Rebani Jaupi, përmendi se PSH, si përfituesi kryesor i Programit SCPA, mbetet e përkushtuar për të zbatuar filozofinë e policimit në komunitet dhe për të siguruar bashkëpunimin me komunitetin për të rritur sigurinë. PSH është angazhuar në mënyrë aktive në aktivitetet e programit dhe ka diskutuar zbatimin e tyre hap pas hapi. PSH është e kënaqur të shohë që aktorë të tjerë nga institucionet shtetërore, qeverisja vendore dhe shoqëria civile janë përfshirë gjithashtu në zbatimin e aktiviteteve, pasi qëllimi i policimit në komunitet është që këta aktorë të bashkëpunojnë, në mënyrë që të kontribuojnë së bashku në rritjen e sigurisë në komunitetet tona.



Znj. Linda Gjermani, përmendi se Qeveria e Suedisë mbetet e përkushtuar për të mbështetur PSH në zhvillimin e fushave të sigurisë publike dhe policimit në komunitet. Ajo shtoi se Raporti i Progresit është një pasqyrim i rezultateve të arritura nga programi SCPA në të gjithë komponentët e tij gjatë fazës së tretë. Programi SCPA ka adresuar nevojat e përfituesve dhe ka përditësuar qasjet përkatëse. Zbatimi i Programit SCPA funksionon mirë si rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyer të përfituesit të tij kryesor, Policisë së Shtetit.

Andi Shundi, Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit SCPA, shpjegoi progresin e bërë deri më tani në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të planit të punës gjatë semestrit të dytë dhe gjithashtu u përqendrua në aktivitetet e parashikuara që do të zbatohen në semestrin e ardhshëm.

Palët e interesuara të programit patën diskutime në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të programit në funksion të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional. Takimi përfundoi me miratimin unanim të Raportit të Parë të Progresit të SCPA-së. Të gjithë palët e interesuara shprehën vlerësimin e tyre për bashkëpunimin e frytshëm dhe të suksesshëm me Programin dhe shprehën gatishmërinë e tyre për bashkëpunim dhe angazhim të mëtejshëm.



Takime informuese me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile për vendet vakante si anëtarë të Shoqërisë Civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile

Shtator 2025

Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile organizoi takime me të gjitha OJF-të e interesuara për të marrë pjesë në takimet që u mbajtën në kuadër të informimit për procesin e zgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile.

Takimet u organizuan si mëposhtë:

1. Durrës në datën 08 Shtator 2025
2. Vlorë në datën 08 Shtator 2025
3. Berat në datën 10 Shtator 2025
4. Gjirokatër në datën 16 Shtator 2025
5. Sarandë në datën 16 Shtator 2025
6. Korçë në datën 18 Shtator 2025
7. Shkodër në datën 22 Shtator 2025
8. Pukë në datën 22 Shtator 2025
9. Tiranë në datën 26 Shtator 2025

Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile ka zhvilluar disa takime informuese me përfaqësues të Shoqërisë Civile në kuadër të thirrjes për pjesëmarrje mbi procesin e përzgjedhjes së 5 (pesë) vakancave të krijuara për anëtarët e Shoqërisë Civile në KKSHC.

Për të gjithë palët e interesuara aplikimet u hapën duke filluar nga data 26 shtator deri në 10 tetor 2025.

Aktivitetet vijuan me prezencën e të ftuarve dhe prezantimin e qëllimit të takimeve ku të pranishmit, morën pjesë aktivisht në takime.

Takimet u mbajtën me përfaqësues të ndryshëm të Shoqërisë Civile dhe u prezantuan në mënyrë të hollësishme mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Përvç këtyre dhe mbi sfidat që kishte hasur ndër vite funksionimi i KKShC-së. U prezantuan disa nga temat aktuale që Këshilli po përballej dhe gjithashtu për arritjet që ky Këshill kishte realizuar.

Temat kryesore si më poshtë:

- Problematika mbi regjistrin elektronik të OJF-ve dhe lidhja me sistemin e ri që po përgatitet nga Drejtoria e Tatim Taksave;
- Zbatueshmëria e Ligjit që përjashton OShC-të nga detyrimi i TVSH-së ;
- Mbi procesin e hartimit të Udhërrëfyesit të Ri për Shoqërinë Civile;
- Procesi integritetit të Shqipërisë në BE, roli i organizatave të shoqërisë civile në këtë proces dhe në përfshirjen e Komitetit të Përbashkët Konsultativ të shoqërisë civile;



- Bashkëfinancimi publik për projektet e BE-së dhe formulari i përjashtimit nga TVSH për projektet e financuara nga BE;
- Përfundimi i suksesshëm i Raportit të Vlerësimit brenda afateve të parashikuara;



Më pas takimet vijuan duke njoftuar të pranishmit për përfundimin e mandateve të disa anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile dhe u paraqitën si mëposhtë fushat e veprimit dhe numri i anëtarëve që ju ka mbaruar afati për të qënë anëtarë të KKShC-së.

- **Fusha e Veprimit A** – *Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE*, ka hapsirë për 3 (tre) anëtarë.
- **Fusha e Veprimit B** – *Zhvillimi ekonomik, territorial e mjedisor*, ka hapsirë për 2 (dy) anëtarë.

Në vijim shpjguam dokumentat të cilat duhet të dorëzojë çdo aplikant i cili ka interes për të qënë anëtar në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile. Dokumentat janë të përcaktuara në rregulloren e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.


Pas kësaj u shpjguua në mënyrë të detajuar se si do ishin fazat e kandidimit, dhe se si do të funksiononte votimi për kandidatët që kalonin në këtë fazë.



NJOFTIM PËR FITUESIT E PROCESIT TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË SHOQËRISË CIVILE NË KKSHC

Tetor – Nëntor 2025

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC), njoftoi mbylljen e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për 5 (pesë) vakancat e krijuara për përfaqësuesit e Shoqërisë Civile në KKSHC.



Pas shqyrtimit të aplikimeve të pranuar gjatë periudhës 26 Shtator – 10 Tetor 2025 dhe pas vlerësimit të plotë të dokumentacionit të dorëzuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në thirrjen publike, komisioni përkatës ka hapur votimin online për kandidatët nga data 28 Tetor 2025 – 4 Nëntor 2025.

Pas numërimit të votave janë shpallur fituesit si më poshtë:

Fusha e veprimit A: Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE

1. Znj. Miriam Reçi Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
2. Znj. Irena Topalli Shoqata Përtej Barrierave
3. Znj. Blerta Tuci EU Policy HUB/ Forumi i Politikave të Integritimit

Fusha e veprimit B: Zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor

1. Znj. Arta Nikolli Consulting and Development Partners
2. Z. Vilson Shehu The Youth of Ura

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile i falenderon të gjitha organizatat dhe kandidatët që morën pjesë në këtë proces për angazhimin dhe kontributin e tyre.

Për çdo informacion shtesë mund të kontaktoni në adresën elektronike: kkshc@amshc.gov.al

Takimi i Ekipit Tematik për Monitorimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Viktimave të Krimit

12 Nëntor 2025

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile morën pjesë në takimin e Ekipit Tematik për Monitorimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Viktimave të Krimit 2024-2025.



Më datë 12 nëntor 2025, në ambientet e Minsitrisë së Drejtësisë u zhvillua: Takimi i Ekipit Tematik për Monitorimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, për periudhën 2024 - 2025.

Zëvendësministrja e Minsitrisë së Drejtësisë, znj. Elona Hoxha vlerësoi kontributin e çdo institucioni pjesëmarrës dhe angazhimin e përbashkët në zbatimin e Strategjisë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të mëtijshëm lidhur me këtë fushë me ndjeshmëri të lartë për shoqërinë.



Gjatë takimit, u prezantua draft-raporti i monitorimit për gjashtëmujorin e parë të vitit ku u analizua ecuria e zbatimit të masave të parashikuara në Strategji, si dhe evidentuan sfidat, rezultatet dhe prioritetet për periudhën e ardhshme; forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe identifikimin e fushave ku kërkohen ndërhyrje të mëtijshme për garantimin e mbrojtjes efektive të viktimave të krimit.



Konferenca e parë Rajonale në lidhje me programin ReLOaD 3

12-13 Nëntor 2025

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile morën pjesë në Konferencën e parë Rajonale në lidhje me programin ReLOaD 3, i cili zhvillohet në vazhdimësi të programeve ReLOaD 1 dhe ReLOaD 2, i zbatuar nga programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe i financuar nga Bashkimi Europian.



Programi është i përqendruar në forcimin e demokracisë dhe bashkëpunimin midis autoriteteve vendore dhe organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-të).

Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3) është një nismë rajonale e financuar nga Bashkimi Europian dhe e zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Programi synon të forcojë angazhimin qytetar dhe partneritetet midis qeverive vendore (QVs) dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) për të krijuar komunitete më të hapura, gjithëpërfshirëse dhe rezistente.

ReLOaD3 ndërton mbi suksesin e fazave të mëparshme (ReLOaD1 dhe ReLOaD2), të zbatuara nga viti 2017 deri në 2024 në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

ReLOaD3 (shkurt 2025 – janar 2029) synon të:

- Forcojë vetëqeverisjen vendore dhe angazhimin e shoqërisë civile në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor.
- Rrisë kapacitetet e qeverive vendore dhe OSHC-ve për të krijuar partneritete efektive, përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe për t'i përafëruar ato me prioritetet e zhvillimit lokal.
- Përmirësojë dialogun dhe bashkëpunimin midis QV-ve dhe OSHC-ve përmes promovimit të praktikave të transparencës në financimin e OSHC-ve.
- Mbështesë qëndrueshmërinë e OSHC-ve përmes zhvillimit të kapaciteteve.
- Inkurajojë qeveritë vendore të adoptojnë dhe ruajnë standarde të larta transparence dhe llogaridhënieje.
- Nxisë dialog të orientuar drejt rezultateve midis OSHC-ve, banorëve dhe autoriteteve, duke kontribuar në qeverisje vendore më gjithëpërfshirëse dhe zhvillim të qëndrueshëm komunal.



Mjedisi Politik:

Krijimi i një mjedisi të favorshëm politik dhe një rrjeti aktorësh për të mundësuar zgjerimin e mekanizmave transparentë të financimit për OSHC-të.



Ndërtimi i Kapaciteteve: Rritja e kapaciteteve të qeverive vendore dhe OSHC-ve për dialog efektiv dhe zbatim të skemave të granteve lokale.

Angazhimi Qytetar: Mbështetja e autoriteteve vendore, shoqërisë civile dhe banorëve për të nxitur angazhim më të madh qytetar në hartimin, ofrimin dhe monitorimin e politikave lokale.

Partneritetet: Forcimi i partneriteteve midis autoriteteve dhe shoqërisë civile dhe rritja e mbikëqyrjes civile mbi politikat publike në Kosovë përmes rrjetëzimit rajonal dhe futjes së mjeteve digjitale.

Buxheti i përgjithshëm për ReLOaD3 është 13.4 milionë USD



Takimi në kuadër të programit “Akademia e OJF-ve 2025”

Tiranë, 19 Nëntor 2025

Pranë ambjenteve të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile u zhvillua takimi në kuadër të programit “Akademia e OJF-ve 2025” nga Partnerët Shqipëri në bashkëpunim me Organizata të shoqërisë civile dhe institucionit AMSHC.

Programi i përvitshëm i Akademisë konsiston në 11 leksione, si dhe asistencë dhe mentorim organizatat. Krahas tyre, një komponent i tretë i programit lidhet me zhvillimin e vizitave/takime prezantuese në institucione të tjera të rëndësishme për sektorin dhe që kanë lidhje me temat e trajtuara si pjesë e kurrikulës së Akademisë.



Qëllimi kryesor i takimit konsiston në bashkëpunim reciprokë lidhur me marrëdhënien me OJF-të dhe qasjen me sektorin për bashkëpunime dhe përfshirjen e tij në projekte e procese të ndryshme.



Takim konsultativ për forcimin e rolit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 11 Dhjetor 2025



Në bashkëpunim me anëtarë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), u zhvillua një takim konsultativ me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Tiranë, me fokus diskutimin mbi funksionimin aktual dhe drejtimin e ardhshëm të Këshillit.

Takimi shërbeu si një hapësirë e hapur për shkëmbim mendimesh, ndarje përvojash dhe reflektim të përbashkët mbi fushat që kërkojnë përmirësim. Pjesëmarrësit ndanë perspektiva dhe rekomandime të vlefshme, me synimin për të forcuar rolin e KKSHC-së dhe për të rritur efektivitetin e tij në përfaqësimin e shoqërisë civile.

Ky aktivitet u organizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, si pjesë e një procesi më të gjerë konsultimi që synon identifikimin e boshllëqeve ekzistuese dhe hartimin e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e punës së Këshillit.



Kontributet dhe reagimet e mbledhura gjatë takimit do të shërbejnë si bazë për hartimin e një raporti analitik, i cili do të pasqyrojë mangësitë e

perceptuara dhe do të ofrojë rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të punës së Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Ruajtja e mekanizmave aktivë, gjithëpërfshirës dhe transparentë të dialogut me shoqërinë civile mbetet thelbësore për nxitjen e një pjesëmarrjeje kuptimplotë dhe efektive.



AMSHC ➤ Ditar 33

Korrik – Dhjetor 2025

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adresa: Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 4 22 355 69

E-mail: info@amshc.gov.al

Website: www.amshc.gov.al